



REPUBLIKE KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D / DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. faks	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-4301/14
Bri. Prot.	
Prot. No	
Data	20.11.2014
Datum	
Date	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.11.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK– 03-3761/14, për z. Skender Dreshaj – Drejtor Ekzekutiv në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3761/14, për z. Skender Dreshaj – Drejtor Ekzekutiv në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Dreshaj, është hetuar për konflikt interesi në ushtimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat O.GJ. “Skender Dreshaj”.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkressë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet t'i bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Dreshaj është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 4172/14) me të cilën vërtetohet se në biznesin privat O.GJ. "Skender Dreshaj" ka emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar. Me këtë z. Dreshaj ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrrupsionit

Hasan Preteni

